



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers  
Inspektorati Qendror i Punës/Centralna Inspektorat Rada/ Central Labour Inspectorate



01Nr.1305-99/2026-V

Inspektori i Punës në Inspektoratin Qendror të Punës në regjionin e Prishtinës, [REDACTED], i autorizuar sipas nenit 82 dhe 94 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, dhe Ligjit Nr.03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, nenit 38 dhe 39 të Ligjit nr.08/l-067 për Inspektimet, konform ankesës së parashtruar në Inspektoratin Qendror të Punës, e protokoluuar me datë 24.12.2025, dhe me nr.prot.1293, nga [REDACTED] ndaj subjektit Horizion Plus, me NUI: 810176538, adresa:Rr. " B", Residjo H/4-nr.17, më datë 14.01.2026, nxjerrë këtë :

## V E N D I M

- I. Inspektorati Qendror i Punës është **JO KOMPETENT** lidhur me ankesën e palës ankuese [REDACTED].
- II. Përfundohet procedimi administrativ në shkall të parë të Inspektoratit Qendror të Punës i filluar sipas ankesës së protokoluuar në IQP me datë 24.12.2025, dhe me nr.prot.1293, nga [REDACTED].

### Arsyetim

Inspektori i Punës ka pranuar ankesën e parashtruar në Inspektoratin Qendror të Punës, e protokoluuar me datë 24.12.2025, dhe me nr.prot.1293, nga [REDACTED]. Inspektori i Punës bazuar në pretendimet ankimore të palës ankuese, me rastin e trajtimit të lëndës nuk ka gjetur bazë ligjore për të trajtuar ankesën, për shkak se Inspektorati Qendror i Punës nuk ka kompetencë të trajtoj qështjet të cilat janë në kompetencë të administratës shtetërore, konkretisht Ministrive Shtetërore të Kosovës.

Luteni t'i drejtoheni organeve kompetente, të cilat mirren me qështjen të cilën e keni adresu në Inspektoratin Qendror të Punës.

Duhet theksuar se IQP-ja , ka kompetencë të trajtoj qështjen se a janë të lajmëruar në ATK, në bazë të nenit 7.4 të Ligjit 03/L-212 të Punës, por jo a i paguhet kontributet pensionale.

Prandaj, në bazë të rrethanave të theksuara më lartë, u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim është përpiluar në kopje të mjaftueshme identike nga një 1 kopje i dorëzohet palëve në procedurë, ndërsa kopjet tjera Inspektorët e Punës i mbajnë për procedurë të mëtutjeshme.

Inspektori i Punës

  


**Udhëzim juridik:** Kundër këtij Vendimi lejohet ankesë në afat prej 30 ditësh, në Komisionin e Ankesave të Inspektoratit Qendror të Punës, nëpërmes Inspektoratit Qendror të Punës në Prishtinë, “Objekti Qendra Tranzite Postare, Zona Industriale, magjistranja Prishtinë – Fushë Kosovë”.